



Reformat shkollore 2009



Stadt Zürich
Schulamt

Përkrahja praktike– përkrahja integruese për fëmijët me kërkesa të veçanta

Në bazë të rregullores për masa të veçanta pedagogjike, në qytetin e Cyrihut, në të ardhmen fëmijët me kërkesa të veçanta, sipas mundësive, mësimin do ta vijnë në klasë të rregullta. Kjo përfshinë nxënës dhe nxënese krejt të ndryshëm: ata me talent të veçantë, fëmijët me gjuhë gjermane si gjuhë të dytë, si dhe ata me kërkesa të posaçme në mësim dhe sjellje. Nga viti shkollorë 2009/10 në qytetin e Cyrihut nuk do të ketë më klasë të vogla.

Kërkohen rrugë të reja (riorjentime) - në vend të ndarjes integrim

Krahasuar me vitet e fundit, pjesëmarrja e lartë e fëmijëve në klasë të vogla dhe në shkollat e veçanta në kantonin e Cyrihut, është në rritje e sipër. Kjo tendencë duhet të ndalet përmes kushteve paraprake kantonale dhe praktikës së re përkrahëse të qytetit. Përvojat e deritanishme integruese, bazuarë në masat e veçanta pedagogjike, në komuna të ndryshme të Cyrihut, si dhe hulumtimet nacionale dhe internacionale kanë treguar qartë se të gjithë fëmijët dhe të rinjtë përfitojnë nga modeli integrues.

Risite më të rëndësishme të përkrahjes praktike në një vështrim:

» Përkrahje Integrative


Përkrahje integrative në përditshmërinë shkollore konkretisht do të thotë, pedagogët përmirsus të shkollës, gjithnjë e më shumë do të shkojnë në shkollë ose në klasat e fëmijëve, dhe jo e kundërta. Mësimdhënësit do të përkrahen dhe këshillohen nga personat e specializuar. Nga bashkëpunimi i tyre mbrenda klasës, përfitojnë të gjithë nxënësit. Shkolla do të forcohet si tërësi. Vazhdimi i mëtutjeshëm i terapive mbështetëse fëmijët dhe të rinjtë me kërkesa të veçanta në orë të mësimi si dhe jashtë saj.

» Shkollimi i veçantë

Nga vera 2009 do të integrohen në klasë të rregullt edhe nxënësit me kërkesa të veçanta. Ata do të mbikqyren në mënyrë intensive nga mësues të shkollës pedagogjike-përmirësuese. Udhëzimet e veçanta për fëmijët me kërkesa të posaçme në përkrahje, dhe për të rinjtë me kërkesa të larta, është edhe më tutje i paraparë vazhdimi i mësimi në shkollë të veçantë (si p.sh. shkollimi në shkollë të veçantë ditore).

» **Bisedë shkollore vlerësuese**

Biseda shkollore vlerësuese është instrument i rëndësishëm për përkrahje në praktikë, si dhe udhëzim i mëtutjeshëm për marrjen e masave të veçanta pedagogjike. Në këtë bisedë merren parasysh idetë e të gjithë pjesmarrësve (prindërve, personelit mësimor, udhëheqësive të shkollës, etj.). Në këtë mënyrë përforcohen përgjegjësitë e përbashkëta. Në bisedat e rregullta vlerësuese, vlerësohen masat e marrura për domosdoshmërinë dhe ndikimin e tyre.



Shkolla sekundare – përmirësimi i mundësive për të drejta të barabarta

Shkolla sekundare në qytetin e Cyrihut në vitin shkollor 2009/10 do të formohet rishtazi në tri shkallëzime. Nga viti 2009 fillon viti i parë i shkollës sekundare të qytetit me 2 degë (A dhe B) si dhe 2 deri 3 lëndë në 3 shkallë kërkesash të mundëshme (I, II, III). Ky model mësimorë do të zbatohet në qarkun shkollorë Limattal si dhe në 35 përqind të të gjitha komunave të Kantonit të Cyrihut.

Strukturat e reja – Modeli i shkollës sekundare të qytetit të Cyrihut

Strukturat e shkollës sekundare ndërtohen sipas modelit të mëparshëm të ciklit të lartë. Të rejat janë; përcaktimet në 2 shkallë A dhe B (në vend të Sek A, Sek B dhe Sek C deri më tani), mundësia e kalimit të diferencuar në lëndë të veçanta (shkallët e kërkesave të mundëshme I, II, III), si dhe mundësia e përmirësimit të kalueshmërisë së sistemit. Aftësitë mësimore individuale të të rinjëve sipas modelit të ri, mund të mirren më mirë parasyshtë. Kalimi nga klasa e 6 në ciklin e lartë bëhet ashtu si më parë, pa provim pranues, në bazë të një vlesimi të përgjithshëm.

Risite më të rëndësishme të shkollës sekundare në një vështrim:

» Kategoritë

Mësimi do të zhvillohet në klasën bazë në të dy kategoritë, A (me kërkesa të zgjëruara) dhe B (me kërkesa themelore). Të rinjtë i ndjekin mësimet në klasën e tyre bazë, në lëndët mësimore; gjermanisht, anglisht, dituri natyre dhe shoqërie, art, muzikë dhe sport.

» Lëndët me shkallë kërkesash të ndryshme

Në lëndet mësimore, frëngjisht dhe matematikë (mbase edhe anglisht) do të zhvillohen kurse rezultatesh me mundësi kalimi nga një kategori në tjetrën në 3 shkallë kërkesash të ndryshme. Nxënësit vijnë në mësimin e lëndeve sipas rezultateve të tyre në shkallë kërkesash: shkalla III = kërkesa themelore, shkalla II = kërkesa të mesme dhe shkalla I = kërkesa të zgjëruara.

» Grupe mësimore të kombinuara


Mundësia e aplikimit të kategorive A / B është kryesisht e mundur. Në këtë strukturë, mësimi i individualizuar është i rëndësishëm së veçantë. Te numri i vogël i nxënësve mund të jetë i domosdoshëm zhvillimi i mësimin në grupe mësimore të kombinuara.

» **Kategorizimi dhe dëftesa**

Sipas sistemit të ri, kalueshmëria duhet të përmirësohet. Kjo do të thotë, kalimi në kërkesa më të larta në përputhje me rezultatet në mësim, të bëhet i mundur pa humbjen e vitit. Ndarja në një kategori si dhe shkallëzimi, sa i përket lëndëve; frëngjisht dhe matematikë (mbase edhe anglisht) të bëhet sipas dëftesës.

Pilot projekt (Eksperimental) riformimi 3. Sek

Projekti i riformimit të 3. Sek, i cili provohet në kantonin e Cyrihut ka për qëllim riformimin e përmbajtjes si dhe organizimin e klasës së 3. Sekundare. Kjo bazohet në bisedat individuale vlerësuese të nxënësve me instrument testimi “Stellwerk” në klasën e 2. Sekundare. Për momentin vazhdon shkalla e dytë e fazës shumëvjeçare provuese të pilot projektit. Këshilli i arsimit ka miratuar aplikimin e tij në një rrafsh të gjërë, duke filluar nga viti shkollor 2009/10 (vendim i këshillit arsimor shkurt 2008). Që nga viti 2005 shkolla Döltschi e qytetit të Cyrihut merr pjesë si shkollë pilot në shkallën e parë.



Strukturat ditore – një transformim kulturorë në shkollë

Që nga viti i ardhshëm shkollorë strukturat ditore do të shtrihen në një hapësirë të gjërë në shkollat e qytetit të Cyrihut. Aktualisht zhvillohen biseda intenzive për sigurimin e lokaleve në mënyrë që ofertat për përkujdesje të jenë në disponim, në përputhshmëri me kërkesat e fëmijëve. Deri në vitin 2011, duhet të ofrohet një vend përkujdesjeje për secilin fëmijë që ka nevojë për të.

Modeli i ri për përkujdesje – dhe modeli udhëheqës

Nga viti shkollor 2009/10 përkujdesja do të jetë si lëndë e re mësimore, krahas mëimit dhe shërbimit shtëpiak, e integruar në shkollë dhe nën mbikqyrjen e udhëheqësisë së shkollës. Zbatimi vazhdon deri në vitin 2012. Ndërmarrja dhe udhëheqja e përbashkët e personelit paraqet nevojën e udhëheqjes së re në shkallë funksionale në lëminë e përkujdesjes.

Të rejtat më të rëndësishme të strukturave ditore në një vështrim:

» Vendosja e strukturës ditore

Në të ardhmën, të gjitha shkollat e qytetit ofrojnë strukturë ditore nga ora 7:00 deri në ora 18:00.

Përkujdesja vullnetare me pagesë, zëvendëson kohën e mëimit (kohën bllok paradite, mësimin pasdite) me strukturë ditore.

Për kopshte, për ciklin themelorë dhe ciklin primar të shkollës fillore, sipas kërkesës ekziston oferta e përkujdesjes, me pagesë nga ora 7:00 deri në ora 8:15 dhe nga ora 11:55 deri 18.00, ku koha e përkujdesjes gjatë drekës kufizohet nga ora 11:55 deri në ora 14:00.

Gjatë pushimeve shkollore bëhet organizimi i përkujdesjes sipas kërkesave.

Nxënësit e shkollës sekundare, mundën ta shfrytëzojnë ofertën e përkujdesjes në drekë, e cila ju përgjigjet kërkesave të tyre të veçanta, në mënyrë fleksibël dhe me pagesë.

» **Njësi përkujdesjeje në shkolla**

Lidhja profesionale në lëminë e përkujdesjes në shkollë formon një organizim të përbashkët pedagogjik si dhe çmon lartë në mënyrë unanime edukatën e nevojshme të personelit shkollorë. Bashkëpunimi i rregulluar qartë mundëson përdorimin optimal të njohurive profesionale dhe resurseve.

» **Orari i ri i punës dhe tarifat**

Orari i ri i punës i ofertës për strehë ditore, si dhe tarifat do t'i përshtaten strukturës së re ditore duke filluar nga 1. Janari 2009. Në adresën e faqes së internetit, www.stadt-zuerich.ch/schulen në rubrikën "Betreunng" gjeni informata të tjera. Për pyetje eventuale keni në disponim numrin tonë të telefonit: 044 413 85 85.

Koha	Strukturat e reja ditore oferta me ose pa pagesë
07	Përkujdesje në mëngjes
08	
09	
10	Koha bllok e shkollës
11	
12	Përkujdesje gjatë drekës
13	
14	
15	Përkujdesje në mbrëmje
16	
17	
17	

Impressum

Herausgegeben von

Schul- und Sportdepartement der
Stadt Zürich

Gestaltung

BR Vision GmbH

Erscheinungsdatum

11/2008



Stadt Zürich
Schulamt